

# “PATIKA ALBANIA” SH.P.K

## AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “PATIKA ALBANIA” SH.P.K

Me vullnetin tonë të lirë, të shprehur edhe me nënshkrimin e këtij Akt-Themelimi në cilësinë e ortakëve themelues, ne:

- **Z. YIGIT ARMAN**, shtetas shqiptar, lindur në Ankara, Turqi, më 07/02/1986, mbajtës i kartës së identitetit të Republikës së Shqipërisë me nr. 034301839 dhe me nr. personal I60207113A, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **ZNJ. ARZU ZEYNEP KABADAYIOGLU**, shtetase turke, lindur në Fatih, Turqi, më 02/03/1990, mbajtëse e pashaportës së Republikës së Turqisë me nr. U35896918, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **Z. SINAN CAN ERDAL**, shtetas turk, lindur në Salihli, Turqi, më 25/06/1985, mbajtës i pashaportës së Republikës së Turqisë me nr. U21420854, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

krijojmë sot më datë 30/09/2024 shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**PATIKA ALBANIA**” SH.P.K me akt themelimi si vijon:

Akt Themelimi i shoqërisë tregtare “**PATIKA ALBANIA**” SH.P.K është i mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

### Neni 1

#### Forma dhe emri i shoqërisë

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “**PATIKA ALBANIA**” SH.P.K. Shoqëria do t'i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t'i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

### Neni 2

#### Selia e Shoqërisë

Selia e shoqërisë “**PATIKA ALBANIA**” SH.P.K do të jetë në adresën:

- **Rruga “Selim Brahja”, afër shkollës “Ibrahim Brahja”, Nd: 50, H:1, Sauk, Tiranë.**

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë sipas parashikimeve të Statutit.

### Neni 3

#### Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj tregtar në fushat si vijon; Kryerjen e aktivitete të udhëtimeve turistike, organizime të udhëtimeve, pushimeve ose guidave tursitike individuale dhe kolektive, ose ndërmjetësimin për shitjen e produkteve të këtij aktiviteti, rezervimi i vendeve në mjetet e transportit të udhëtarëve, marrja dhe vënia në dispozicion me qira totale ose pjesërisht e këtyre mjeteve të transportit, rezervimi i dhomave në hotelet turistike, porositja e të ngrënit në restorantet turistike,

## “PATIKA ALBANIA” SH.P.K

dorëzimi i bonove të rezervimit dhe të porositjes ne mjetet e transportit, hotele dhe restorante; Shërbime të lidhura me pritjen turistike, si organizimi i vizitave në shtete, qytete, muze, monumente, vende të veçanta, etj; shërbimi i guidëpërkthyesve, shoqëruesve në dhënie e informacioneve për udhëtime e turizëm, të programuara paraprakisht ose sipas dëshirës së klientëve. Shërbime transporti turistik, organizimi i udhëtimeve për turistët me mjete të të tretëve apo të vetë shoqërisë; konsulenca në këtë fushë dhe në fusha të tjera, gjetja, menaxhimi dhe shpërndarja e personelit specialist në fusha të ndryshme, trajnimi dhe konsulenca për menaxhimin, aktivitete të tjera të burimeve njerëzore. Import – eksport, tregtim fizik dhe tregtim online i çdo lënde të parë, malli, artikulli, pajisje, makinerie, shërbimi dhe produkti; shërbime reklame dhe marketingu të mallrave, artikujve dhe produkteve të ndryshme; blerje, shitje, operim, marrje me qira, dhënie me qira, transkasion të çdo lloji në lidhje me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Menaxhim dhe zhvillim të çdo lloj software, faqe interneti, web, aplikacione mobile, automatizim, shërbime të sigurisë kibernetike, shërbime të mediave sociale, shërbime serveri, kompjuteri, konsulencë IT, shitje, blerje, mirëmbajtje të çdo lloj programi kompjuterik, aplikacioni, server, kompjutera, pjesë këmbimi të tyre, të artikujve të ndryshëm etj. Shërbim konsulencë në këto fusha. Shoqëria mund të kryejë me qëllim arritjen e objektivave të biznesit të shoqërisë, çdo veprim tregtar, industrial, financiar dhe transaksion, të cilat janë të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektivave të Shoqërisë.

Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve sipas kushteve për ndryshimin e Statutit.

### Neni 4

#### Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfardo lloj shkaku.

### Neni 5

#### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100 lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre, si mëposhtë.

##### **Ortaku themelues YIGIT ARMAN:**

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 51.00 % (pesëdhjetë e një përqind), kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 51.00 (pesëdhjetë e një) lekë

##### **Ortaku themelues ARZU ZEYNEP KABADAYIOGLU:**

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 25.00 % (njëzetë e pesë përqind) kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 25.00 (njëzetë e pesë) lekë

##### **Ortaku themelues SINAN CAN ERDAL:**

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 24.00 % (njëzetë e katër përqind) kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 24.00 (njëzetë e katër) lekë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

# “PATIKA ALBANIA” SH.P.K

## Neni 6

### Drejtimi i Shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga Administratori i shoqërisë, i cili është:

➤ **YIGIT ARMAN**, me adresë Vilat Rrolling Hills, Vila Nr. 79, Mullet, Tiranë

Administratori është përfaqësues i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe kanë kompetenca të plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tyre dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Specimenti i nënshkrimit:

## Neni 7

### Të ardhurat

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë Ortakëve të shoqërisë.

## Neni 8

### Emërimet

Ortakët themelues kanë të drejtë të emërojnë dhe administratorë të tjerë, ka të drejtë të caktojnë financiarë, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë.

## Neni 9

### Zgjidhja e konflikteve

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## Neni 10

### Vula e shoqërisë

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

*Akti i themelimit u përpilua në 4 (katë) kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “PATIKA ALBANIA” SH.P.K.*

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë

# “PATIKA ALBANIA” SH.P.K

**YIGIT ARMAN**

**SINAN CAN ERDAL**

**ARZU ZEYNEP KABADAYIOGLU**

